

BAZA LIGJORE:

- Ligji Nr. 8378 datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 153, datë 07.04.2000 “Mbi miratimin e rregullores për zbatim të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” e ndryshuar;
- Udhëzim i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 241/3, datë 19.02.2016 “Mbi karakteristikat e materialit, elementët e sigurisë, elementët grafikë dhe mënyra e plotësimit të lejedrejtimit të ri të mjeteve rrugore”;
- Udhëzim i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 682/4, datë 1.4.2016 "Për aktivitetin e autoshkollave, pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)".

Kjo bazë ligjore ka për qëllimin implementimin e plotë të Direktivës 2006/126/EC “Mbi lejet e drejtimit”.

Autoriteti lëshues i lejeve të drejtimit në Republikën e Shqipërisë është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), e cila është në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).